

FTESË PËR OFERTË

Ref no: T-0010-03-2010

ProCredit Bank, banka më e suksesshme në Kosovë i fton të gjitha kompanitë e specializuara dhe të interesuara për :

Furnizim me tonerë, si dhe Servisimi dhe Mirëmbajtje të rregullt të fotokopjeve, printerëve dhe Faks makinave në objektet e ProCredit Bank-ës në Kosovë

Të interesuarit mund ti marrin dokumentet për aplikim prej datës 04 Mars 2010 në ProCredit Bank – Zyra Qendrore Bulevardi Nëna Terezë Nr.16- Prishtinë.

Vërejtje:

- ProCredit Bank është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e ofruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së, ndërsa ofertuesit që nuk janë deklarues të TVSH-së (bëjnë shitje të përjashtuar nga TVSH-ja), nuk duhet të listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së.
- Për çmimet të cilat nuk e kanë të listuar TVSH-në ndarazi, do të nënkuptohet se vlera e TVSH-së është e përfshirë brenda çmimit .
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë dy muaj(60 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Çmimet kuotohen në Euro(€).
- Personeli adekuat dhe i kualifikuar (kopjet e dokumenteve përkatëse për personelin).
- Ofertuesi duhet të ketë përvojë minimum 3 vjeçare në ofrimin e shërbimeve të tilla dhe të jete i autorizuar për punët e përshkruara më lartë (kopjet e dokumenteve të kërkuara).
- Ofertuesi duhet të prezantojë referenca dhe certifikata mbi punët e lartshënuara (kopje të certifikatave, kontratave dhe referencave aktuale).
- Dëshmi për pajisjet dhe logjistikën e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të tilla.
- Asnjë shpenzim që e bëni gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kuotimit të çmimit nuk do të ju kompensohet.
- ProCredit Banka ka të drejtë të anulojë tenderin dhe/ose ndryshojë karakteristikat e tenderit dhe ti ftojë pjesëmarrësit për ti sjell sërish ofertat e tyre.

Data e fundit për dorëzimin e ofertës së kompletuar është 15 Mars 2010, ora 17:00h.

Oferta në zarf të mbyllur dhe e shënuar qartë „Ofertë për Furnizim me tonerë, Servisimi dhe Mirëmbajtje të fotokopjeve, printerëve dhe faks makinave“ duhet të dorëzohet në Zyrën Qendrore të ProCredit Bank-ës (Bulevardi Nëna Terezë Nr. 16).

ÇDO PYETJE SHITESË RRETH KËSAJ FTESE PËR OFERTË MUND TA ADRESONI NË :

procurement@procreditbank-kos.com